

RELACION SHPJEGUES

PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 797, DATË 29.9.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR MIRATIMIN E RREGULLORES HIGJENO- SANITARE “MBI ADMINISTRIMIN E CILËSISË SË UJËRAVE TË LARJES”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi ka për qëllim përditësimin dhe përshtatjen e kuadrit rregullator për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes, në përputhje me ndryshimet e kuadrit ligjor në fuqi për burimet ujore dhe me nevojën për përcaktimin e qartë të përgjegjësisë të institucioneve përgjegjëse për monitorimin, menaxhimin, vlerësimin dhe informimin e publikut mbi cilësinë e ujërave të larjes.

Në mënyrë të veçantë, projektvendimi synon:

- përditësimin e terminologjisë dhe emërtimeve institucionale, në përputhje me strukturën dhe organizimin aktual të administratës publike;
- përcaktimin e qartë të përgjegjësisë dhe kompetencave të institucioneve që kanë rol në administrimin e ujërave të larjes;
- forcimin e sistemit të monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes;
- përcaktimin e procedurave për njoftimin dhe marrjen e masave në rastet kur konstatohen ndotje ose rreziqe për shëndetin e personave që lahen;
- përmirësimin e mënyrës së vlerësimit dhe klasifikimit të cilësisë së ujërave të larjes;
- rritjen e transparencës dhe informimit të publikut;
- përcaktimin e detyrimeve për raportimin vjetor të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së ujërave të larjes;
- përditësimin e metodologjisë për marrjen, ruajtjen, transportimin dhe analizimin e kampioneve mikrobiologjike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave në katër mujori e dytë të vitit 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

VKM nr. 797, datë 29.9.2010, “Për miratimin e rregullores higjeno-sanitare ”Mbi administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”, ka përcaktuar rregullat për monitorimin, vlerësimin, klasifikimin dhe administrimin e cilësisë së ujërave të larjes, si dhe kërkesat për informimin e publikut.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 797, datë 29.9.2010, të Këshillit të Ministrave, për miratimin e rregullores higjeno-sanitare “Mbi administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”

Pas miratimit të këtij akti kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme në kuadrin ligjor dhe institucional, veçanërisht me miratimin e ligjit nr. 29/2024 “Për burimet ujore”. Për këtë arsye, është e nevojshme që rregullorja ekzistuese të harmonizohet me terminologjinë, parimet dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga legjislacioni aktual.

Gjithashtu, ndryshimet në organizimin dhe funksionimin e institucioneve publike kërkojnë rishikimin e referencave të vjetra institucionale, si dhe përcaktimin e autoriteteve aktualisht përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të parashikuara në rregullore.

Miratimi i projektvendimit është i nevojshëm për përditësimin e kuadrit rregullator për cilësinë e ujërave të larjes, përshtatjen e tij me legjislacionin aktual për burimet ujore dhe qartësimin e përgjegjësiave institucionale.

Ndryshimet e propozuara do të kontribuojnë në një monitorim më efektiv të cilësisë së ujërave të larjes, identifikimin dhe menaxhimin në kohë të ndotjeve, mbrojtjen e shëndetit publik, rritjen e transparencës dhe informimit të publikut, si dhe përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë në kuadër të përafrimit me standardet evropiane.

Nëpërmjet përcaktimit të objektivave për klasifikimin deri në vitin 2027 dhe arritjen e të paktën cilësisë “e mjaftueshme” deri në vitin 2030, projektvendimi synon të sigurojë një përmirësim gradual dhe të matshëm të cilësisë së ujërave të larjes në Republikën e Shqipërisë dhe, në këtë mënyrë, të kontribuojë në mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të zonave të larjes.

Projektvendimi synon, për rrjedhojë, të sigurojë një ndarje më të qartë të përgjegjësiave ndërmjet ministrisë përgjegjëse për mjedisin, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, Institutit të Shëndetit Publik, njësi të vetëqeverisjes vendore dhe strukturave inspektuese përgjegjëse.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8 të ligjit nr.7643, datë 02.12.1992 “Për Shëndetin Publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror”, i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 42, të ligjit nr.10138, datë 11.05.2009, “Për shëndetin publik”, me ligjin nr. 29/2024 “Për burimet ujore”, duke përditësuar referencat dhe terminologjinë e rregullores ekzistuese.

Ndryshimet synojnë gjithashtu të ruajnë dhe përmirësojnë përputhshmërinë e kuadrit kombëtar me kërkesat evropiane për menaxhimin dhe cilësinë e ujërave të larjes, si dhe me detyrimet për monitorimin, vlerësimin, informimin e publikut dhe raportimin.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

VKM nr. 797/2010 është miratuar në përafrim me Direktivën 2006/7/KE për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes.

Ndryshimet e propozuara synojnë ruajtjen dhe forcimin e këtij përafrimi, duke reflektuar njëkohësisht zhvillimet e legjislacionit shqiptar dhe riorganizimin institucional në fushën e administrimit të burimeve ujore dhe mbrojtjes së mjedisit.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 797, datë 29.9.2010, të Këshillit të Ministrave, për miratimin e rregullores higjeno-sanitare “Mbi administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”

Në këtë kuadër, projektvendimi kontribuon në përmbushjen e angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në procesin e integritetit evropian, veçanërisht në drejtim të monitorimit dhe administrimit të cilësisë së ujërave të larjes, mbrojtjes së shëndetit publik dhe informimit të publikut.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi parashikon një sërë ndryshimesh dhe shtesash në dispozitat e VKM-së nr. 797, datë 29.9.2010, si dhe në rregulloren bashkëlidhur tij.

Në mënyrë të përmbledhur, ndryshimet kryesore janë:

1. Përditësimi i terminologjisë institucionale.

Përcaktohet përdorimi i formulimeve “ministra përgjegjëse për...” dhe emërtimeve aktuale të institucioneve, duke shmangur referencat ndaj strukturave që nuk ekzistojnë më ose që kanë ndryshuar kompetencat dhe organizimin.

2. Përditësimi i objektit dhe qëllimit të rregullores.

Rregullorja përcakton në mënyrë më të qartë rregullat për monitorimin dhe klasifikimin e cilësisë së ujërave të larjes, menaxhimin e cilësisë së tyre dhe dhënien e informacionit për publikun. Qëllimi lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

3. Përafrimi i përkufizimeve me ligjin nr. 29/2024 “Për burimet ujore”.

Një sërë termash, ndër të cilët “ujëra sipërfaqësore”, “ujëra nëntokësore”, “ujëra të brendshme”, “ujëra tranzitore”, “ujëra bregdetare”, “basen lumor” dhe “person i interesuar”, marrin të njëjtin kuptim si në ligjin përkatës.

4. Përcaktimi i institucionit monitorues.

Shtohet përkufizimi i “institucionit monitorues”, si institucioni përgjegjës për kryerjen e monitorimit të cilësisë së ujërave të larjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi për monitorimin e mjedisit.

5. Riorganizimi i përgjegjësiwe institucionale.

Përcaktohen më qartë kompetencat e ministrisë përgjegjëse për mjedisin, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, njësiwe të vetëqeverisjes vendore dhe autoriteteve të tjera kompetente.

6. Forcimi i monitorimit.

Parashikohet që për çdo ujë larjeje të kryhet monitorimi gjatë sezonit të larjes, sipas kalendarit të monitorimit. Institucioni monitorues ka detyrimin të informojë autoritetet përkatëse në rast të pezullimit të kalendarit të monitorimit.

Në rast se gjatë monitorimit konstatohen rezultate që tregojnë ndotje ose rrezik për shëndetin e personave që lahen, parashikohet njoftimi i menjëhershëm i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, me qëllim marrjen e masave të nevojshme menaxhuese.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 797, datë 29.9.2010, të Këshillit të Ministrave, për miratimin e rregullores higjeno-sanitare “Mbi administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”

7. Përmirësimi i sistemit të vlerësimit dhe klasifikimit.

Përditësohen dispozitat që lidhen me vlerësimin vjetor dhe klasifikimin e ujërave të larjes, duke krijuar një lidhje më të qartë ndërmjet rezultateve të monitorimit dhe masave menaxhuese.

8. Përcaktimi i përgjegjësive për profilet e ujërave të larjes.

Përditësohen dispozitat që lidhen me hartimin dhe përditësimin e profileve të ujërave të larjes, si dhe me identifikimin e burimeve të mundshme të ndotjes dhe faktorëve që mund të ndikojnë në cilësinë e ujit.

9. Përfshirja dhe informimi i publikut.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ngarkohen me sigurimin e informacionit të nevojshëm për publikun, duke përfshirë klasifikimin aktual të ujërave të larjes, ndalimet e larjes, përshkrimin e ujërave të larjes dhe informacionin lidhur me rreziqet për shëndetin.

10. Raportimi vjetor.

Shtohet një nen i ri për raportimin, sipas të cilit ministria përgjegjëse për mjedisin, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përgatit raportin vjetor mbi rezultatet e monitorimit dhe vlerësimin e cilësisë së ujërave të larjes, si dhe mbi masat e rëndësishme të menaxhimit të ndërmarra.

11. Përditësimi i metodologjisë së marrjes dhe analizimit të kampioneve.

Shtojca V zëvendësohet me një metodologji të përditësuar që përcakton kërkesat për pikën e marrjes së kampionit, sterilizimin e shisheve, mënyrën e marrjes së kampioneve, identifikimin, ruajtjen, transportimin dhe afatet për analizimin e tyre.

Këto ndryshime synojnë rritjen e besueshmërisë së rezultateve të monitorimit dhe garantimin e cilësisë së procesit laboratorik.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e projektvendimit ngarkohen, sipas fushës së përgjegjësisë: ministria përgjegjëse për mjedisin; ministria përgjegjëse për shëndetësinë; ministria përgjegjëse për çështjet e turizmit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore; Instituti i Shëndetit Publik; njësitë e vetëqeverisjes vendore; strukturat inspektuese përgjegjëse dhe autoritetet e tjera kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëpunimi ndërinstitucional është i domosdoshëm për garantimin e monitorimit efektiv, identifikimin në kohë të rasteve të ndotjes, marrjen e masave menaxhuese dhe informimin e publikut.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është përgatitur nga Grupi Ndërinstitucional i Punës, ngritur me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Nr. 114, datë 03.02.2026 për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e vendimit nr.797, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores higjeno-sanitare “për administrimin e cilësisë së

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 797, datë 29.9.2010, të Këshillit të Ministrave, për miratimin e rregullores higjeno-sanitare “Mbi administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”

ujërave të largjes”. Për hartimin e këtij projekt vendimi kanë kontribuar Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Instituti i Shëndetit Publik, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Agjencia Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencia e Manaxhimit të Burimeve Ujore.

Ky projektvendim dërgohet për mendime institucioneve të mëposhtme: Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoratit të Përgjithshëm dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi i propozuar nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

EVIS SALA

